



Shtatë shtyllat e urtësisë së shkollarëve bibliکہ

Description

Robert W. Funk & Roy W. Hoover

Fragment i shkëputur nga libri i Robert W. Funk dhe Roy W. Hoover me titull: "The Five Gospel: The Search for the Authentic Words of Jesus, Macmillan Publishing Company, New York 1993

Kërkimi për Jezusin historik është nxitur nga perspektiva e të vështruarit të Jezusit përmes lenteve të arsyes dhe kërkimit historik më shumë se sapërmes syzeve të perspektivës teologjike dhe formulimeve tradicionale të kredos.

Kërkimi për Jezusin historik filloi me Herman Samuel Reimarus (1674-1768), profesor i gjuhëve orientale në Hamburg të Gjermanisë. Një studim i hollësishëm i Dhjatës së Re e bindi Reimarus-in se ajo që thonë autorët e ungjijve për Jezusin duhet dalluar nga ajo që ka thënë vetë Jezusi përveten etij. Kërkimi për Jezusin historik filloi pikërisht me këtë dallim ndërmjet Jezusit dhe Krishtit të besimit.

Shumica e amerikanëve të shekullit të njëzet nuk janë në dijeni të faktit se një prej bijve të rilindjes, Tomas Xheferson (1743-1826), ka shqyrtuarim tësisht ungjijtë me të njëjtin qëllim në mendje: tëndante mësimin e vërtetë të Jezusit (një person historik), nga guaska e doktrinës së krishterë. Ai imblodhi përfundimet e tij në libërthrin '*Jeta dhe morali i Jezusit nga Nazareti, nxjerrë tekstualisht nga ungjijtë në gjuhën greke, latine, frënge dhe angleze*' (The Life and Morals of Jesus of Nazareth, Extracted textually from the Gospel in Greek, Latin, French, and English), botuar për herë të parë në vitin 1904 dhe ende gjendet në botim. Ndërkohë, në Gjermani, këndvështrimi i Reimarusit dhendjekësve të tij u çua më tej në veprën monumentale të David Friedrich Strauss (botimi i parë 1835) me titull '*Jeta e Jezusit; një këndvështrim kritik*' (Life of Jesus Critically Examined). Strausi bëri dallimin ndërmjet 'mitikes' (e përkufizuar nga ai si gjithçka që është legjendare apo e mbinatyrshme) në ungjijet dhe asaj që mund të quhej si ngjarje historike. Stuhia që shkaktoi studimin e tij prej 1400 faqesh analize të hollësishme i kushtoi atij postin si profesor në Universitetin e Tubingenit. Kritikët e sulmuan atë deri në vdekjen e tij në vitin 1874. Zgjedhja që Strausi bëri gjatë vlerësimit të tij të ungjijve ishte ndërmjet Jezusit të mbinatyrshëm (Krishti i besimit) dhe Jezusit historik. Shkollarë të tjerë në traditë gjermane zhvilluan një kontrast më të ekuilibruar, por jo më pak tërëndësishëm, ndërmjet Jezusit të ungjijve sinoptikë (Mateut, Markut dhe Lukës) dhe ungjillit të Gjonit. Dy prej shtyllave të kritikizmit bashkëkohor biblik ishin vendosur tashmë. I pari konsistonte në dallimin ndërmjet Jezusit historik, i cili duhej zbuluar përmes shqyrtimit historik, dhe Krishtit të besimit të mbërthyer në formulimet e hershmetë të kredos. Shtylla e dytë, konsistonte në njohjen e ungjijve sinoptik si më të afërt me Jezusin historik se sa ungjilli i Gjonit, i cili paraqet një Jezus 'shpirtërorë'.

Duke nisur që nga viti 1900 (e.s.), filloi të vendosej edhe shtylla e tretë dhe e katërt e kritikës biblike bashkëkohore. Njohja e ungjillit të Markut si më i hershëm se ungjijtë e Mateut dhe Lukës, si dhe të qenurit i tij si burim për dy ungjijtë e tjerë përbën shtyllën e tretë të shkollarizmit biblikë. Shtylla e katërt konsiston në identifikimin e një burimi hipotetik të quajtur Q si shpjegimi më i mirë për 'traditat e dyfishta' (materiali i përbashkët i Mateut dhe Lukës i cili është i pavarur nga teksti i Markut). Të dy këto shtylla do të diskutohen në vijim.

Historia tragjike dhe heroike e të gjithë atyre të cilët janë përpjekur të thyenin asfiksimin që kisha i kishte bërë dijes është regjistruar nga Albert Schweitzer në librin e tij të famshëm 'Kërkimi për Jezusin historik' (The Quest of the Historical Jesus) publikuar në vitin 1906. Vetë Schweitzer-i kontribuoi në këtë revoltë në mënyrë domethënëse, duke ndjekur hapat e Johannes Weiss-it në veprën e tij 'Shpallja e Mbretërisë së Perëndisë nga Jezusi' (Jesus' Proclamation of the Kingdom of God (1892)). Për Weiss-in dhe Schweitzer-in dallimi bazë që duhej bërë ishte ky: a mendonte Jezusi se botës po i vinte fundi përmes një kataklizme, njohur si 'eskhaton' (termi grek për të përshkruar ngjarje të fundit), apo ai mendonte se kataklizma do të ndodhte shumë kohë më vonë. Si rrjedhojë Schweitzer-i e shihte etikën e Jezusit vetëm si një 'etikë të përkohshme' (një mënyrë jetese e mirë vetëm për periudhën e shkurtër para kataklizmës përfundimtare, 'eskhatonit'). Për këtë arsye ai e pa etikën e Jezusit si të parëndësishme dhe të pavlefshme për kohën tonë. Duke i qëndruar besnik përfundimeve të tij,

Date Created

16/10/2014

Author

erasmusi